



Kampi verorë i gjuhës

"Shkolla duhet të përpiqet gjithmonë të sigurojë, që të rinjtë t'i lë si një personalitet harmonik, jo si specialist." (Albert Einstein)



„Kampi verorë i gjuhës "është një program për përkrahjen e mësimit të gjuhës për fëmijët e shkollës fillore, i cili kryesisht synon të mësojnë intensivisht gjuhën gjermane. Pas pushimeve të gjata verore, fëmijët përgatiten për vitin e ri shkollor duke u angazhuar ata nga arsimtarët dhe edukatorët e tyre.

Në një mjedis nxitës të mësimit do të mësohet gjermanishtja si gjuhë e parë ose e dytë duke i rifreskuar aftësitë ekzistuese gjuhësore dhe duke i thelluar ato. Para se gjithash përmes lojës dhe interaksionit social do të gjinden në një mjedis ideal të këndshëm. Mësimet janë pjesë e këtij mjedisi mësimor dhe përmbajtja e tyre është e lidhur ngushtë me aktivitetet e kampit.

Qëllimet

- Freskimi dhe përmirësimi i aftësive të gjuhës gjermane
- Përgatitja për shkollë
- kërkesa e motivimit të nxëniet të fëmijëve pjesëmarrës
- Forcimi i vetëvlerësimit emocional të fëmijëve pjesëmarrës
- Forcimi i aftësive sociale dhe ndërkulturore për të gjithë të përfshirë
- Forcimi i bashkimit dhe kohezionit social

Ofertë e programit

Kampi verorë i gjuhës zakonisht zhvillohet në javën e tretë deri të fundit apo të parafundit të pushimeve verore, nga ora 9:00 e mëngjesit deri në ora 16:00. Ky kamp mbahet në disa lokacione (kryesisht në shkolla) të Austrinë së Epërme. Mësimi zhvillohet në mëngjes, kurse dhe pasdite mbahen aktivitete të ndryshme interesante të kohës së lirë. Gjithashtu gjatë kampit ndërmerren ekskursione dhe bëhet edhe një festë përfundimtare me shumë argëtim dhe lojëra që organizohet në ditën e fundit.

Vetëbesimi i fëmijëve në aftësitë e tyre gjuhësore duhet të forcohet përmes aftësisë së të folurit dhe lojërave interaktive që do ti mundëson fëmijës vetë përvojë në një mjedis të mbrojtur. Për këtë arsye, kampi i gjuhëve verore përqendrohet në "të mësuarit në lojë".